



Pranuar / Dërguar / Prijmjen / Predato / Received / Delivered	05-01-2024	viti god year	
Organ / Rjeshtja Org / Jednica Org / Unit	Rr. Prot. Rr. Prot. Prot. No.	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHOCK	102/2024		115



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.764/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetar, Arditë Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bektashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2576/2021 të datës 25.10.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.728/2019 të datës 21.11.2019 të parashtruar nga ankuesja me adresë

kundër Vendimit me Nr. Port:26/19 të datës 22.10.2019 dhe emailit të datës 29.10.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar ma ankesën me numër A.nr.728/2019 të datës 21.11.2019 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Me Vendimin me Nr. Prot: 04/18 të datës 07.02.2018 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë ankuesja është ngarkuar me detyrat e Menaxheres së Personelit në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, mirëpo Udhëheqësi Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë, më datë 22.10.2019 ka nxjerr Vendim me Nr. Prot:26/19 me të cilin ka shfuqizuar vendimin e datës 07.02.2018, ndërsa më datë 29.10.2021 i njëjti organ përmes emailit ka njoftuar ankuesen se përshkrimi i detyrave të punës i hartuar nga ana juaj më datë 15.05.2019 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme i miratuar nga MAP për këtë pozitë ndërsa ju keni shpall pozitën Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme në kundërshtim me aprovimin nga MAP.

Ankuesja e pakënaqur me këtë vendim, përmes e-mailit ankesa.kpmsnck@rks-gov.net më datë 21.11.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.11.2019, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Më datë 02.12.2019 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë prej tri faqeve..

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të mungesës së kuorumit, më datë 23.12.2019, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 05.07.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.178/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 23.12.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 21.11.2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 24.08.2021 ka pranuar Aktgjykimin A.nr.178/2020 të datës 05.07.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, mirëpo për shkak të mungesës së kuorumit sipas Njoftimit të datës 28.09.2021 ka njoftuar pala ankuese dhe gjykatën për arsyet e mos vendosjes së ankesës së ankueses, ndërsa pala ankuese është udhëzuar që mund të ndjek procedurat e tjera gjyqësore.

Ankuesja ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 25.10.2023 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2576/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 28.09.2021 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 21.11.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:

Ankesën me Nr.Prot:5494/2019 të datës 21.11.2019 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Prot:26/19 të datës 22.10.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore; Vendimin me Nr.Prot:04/18 të datës 07.02.2018 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore; Kërkesë për fillimin e rekrutimit e datës 15.05.2019; Organogrami i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore; Formulari i Planit Individual të Personelit datës 08.11.2018; Autorizimin për Publikimin e Konkursit i datës 17.05.2019; Shpalljen e konkursit të brendshëm për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshëm i datës 18.05.2019; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 01.07.2019; Kërkesën e datës 25.10.2019 të ankueses për Udhëheqësin Ekzekutiv; E-mailin e datës 29.10.2019 nga për ankuesen; Planin individual të punës për periudhën korrik-dhjetor 2019; E-mailin e datës 21.11.2019 nga ankuesja; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 26.11.2019; Përgjigjen në ankesë e datës 02.12.2019; Njoftimin e datës 23.12.2019 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për ankuesen; Aktgjykimin A.nr.178/2020 të datës 05.07.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimin e datës 28.09.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për ankuesen dhe gjykatës; Aktgjykimin A.nt.2576/2021 të datës 25.10.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e bërë i pamundur, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses të parashtruara përmes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila konteston Vendimin me Nr. Port:26/19 të datës 22.10.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe emailin 29.10.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Bazuar në të gjitha provat e lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja në ankesën e datës 06.03.2020 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përveç kërkesës për anulim të Vendimit KZKA 02/2020 të datës 07.02.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ka kërkuar edhe anulimin e Vendimit me Nr. Port:26/19 të datës 22.10.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, rrjedhimit ankuesja anulimin e Vendimit me Nr. Port:26/19 të datës 22.10.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, e ka kërkuar edhe përmes ankesës së datës 21.11.2019, respektivisht përmes dy ankesave ka kërkuar anulimin e vendimit të njëjtë.

Duke marr parasysh faktin se ankuesja me Vendimin me Nr. Prot: 04/18 të datës 07.02.2018 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore është ngarkuar me detyrat e Menaxheres së Personelit në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore,

dhe meqenëse procedura për pozitën Udhëheqës i Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme është rekrutuar me konkurs dhe ankueses më datë 01.07.2019 ankueses i është bërë Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit, atëherë Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore me Vendimin me Nr. Port:26/19 të datës 22.10.2019 ka bërë edhe shfuqizimin e Vendimit me Nr. Prot: 04/18 të datës 07.02.2018, kështu që sipas Kolegjit të Këshillit, duke marr parasysh faktin se Vendimi me Nr. Prot: 04/18 të datës 07.02.2018 është shfuqizuar sipas Vendimit me Nr. Port:26/19 të datës 22.10.2019 për arsyet e cekura si më lartë, atëherë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 31.12.2021 ka nxjerr Vendim A.nr.852/2021 ka bërë përfundimin e procedimit administrativ të inicuar sipas ankesës së datës 06.03.2020 të ankueses.

Andaj meqenëse pretendimi i palës ankuese ndaj Vendimit me Nr. Port:26/19 të datës 22.10.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore është shqyrtuar sipas Vendimit A.nr.852/2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se objekti i kësaj ankesë ndaj këtij akti është bërë i pamundur, po ashtu sa i përket pretendimit tjetër që ndërlidhet me emailin e datës 29.10.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Vendimit me Nr. Port: 35/19 të datës 27.12.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore është anuluar procedura e brendshme e rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Personelit dhe Shërbimeve të Përgjithshme, si rezultat i kësaj ky vendim është vërtetuar me Vendimin A.nr.492/2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes të cilit është refuzuar ankesa e datës 21.02.2020 e ankueses.

Duke marr parasysh të gjitha rrethanat lidhur me këtë çështje juridike-administrative, dhe duke marr për bazë konstatimet si më lartë, atëherë Kolegji i Këshillit konstaton se pretendimet e ankueses për anulim të Vendimit me Nr. Port:26/19 të datës 22.10.2019 dhe emailit të datës 29.10.2019 të Udhëheqësit Ekzekutiv të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, janë bërë të pamundura, ngase konstatohet në këto rrethana ankesa e ankueses nuk ka objekt shqyrtimi, kështu që bazuar me dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bënë përfundimin e procedimit administrativ të inicuar me ankesën me numër A.nr.728/2019 të datës 21.11.2019 të parashtruar nga ankuesja.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.764/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Menaxherit të Personelit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

